KËRKESË PËR SHPREHJE INTERESI

SHËRBIME KONSULENCE

(PËR RISHIKIMIN DHE PËRMIRËSIMIN E KODEVE TË NDËRTIMIT NË SHQIPËRI)

PROJEKTI "PËRBALLIMI DHE ZBUTJA E RREZIKUT NGA FATKEQËSITË"
Shërbime Konsulence për rishikimin dhe përmirësimin e Kodeve të Ndërtimit në Shqipëri
Huaja Nr. IBRD75630, Kredia Nr. IDA44600
Nr. Projekti: P110845
Shprehje interesi

Qeveria e Shqipërisë ka marrë një kredi nga IDA, për financimin e kostos së projektit " Përballimi dhe Zbutja e Rrezikut nga Fatkeqësitë", dhe synon të përdorë pjesë të këtyre fondeve për pagesën shërbimeve të konsulencës për përgatitjen e një Udhezuesi Kombetar per procesin e adoptimit te Eurokodeve ne Shqiperi, perkthimin e Eurokodit 8 dhe pjeseve kryesore të Eurokodeve të tjerë që kane lidhje te ngushtë me të'. Si pjesë e ketij shërbimi, konsulenti do pergatisë edhe materiale trajnuese për inxhinierët.

Projekti përmban pesë komponentë. Komponenti i III-të ka si objektiv zbutjen e riskut nga aktiviteti sizmik përmes përmirësimit të kodeve të ndertimit dhe gjetjen e mekanizmave të ndryshëm për prezantimin dhe futjen në përdorim të këtyre standardeve të përmirësuara. Aktivitetet e këtij komponenti janë: (a) përgatitja e kodeve kombëtare të ndertimit; (b) trajnimi i inxhinierëve me standardet e reja.

Periudha e pritshme e fillimit te Shërbimeve te Konsulencës është muaji Prill 2011 dhe kohëzgjatja e tyre do te jete 7 (shtatë) muaj nga kjo datë. Parashikohet që për këto shërbime do të nevojiten në total 350 ditë pune (staf ndërkombëtar dhe lokal).

Kompania konsulente duhet të ketë përvoje teorike dhe teknike për procedurat e projektimit sipas Eurokodeve, veçanërisht në projektimin antisizmik bazuar në Eurokodin 8, eksperiencë mbi proçesin e adoptimit dhe të implementimit te Eurokodeve ne vendet anëtare ose kandidate të BE.

Ekipi i Menaxhimit të Projektit (PMT) "Përballimi dhe Zbutja e Rrezikut nga Fatkeqësitë" në Ministrinë e Brendshme, në koordinim me Ekipin Implementues në Ministrinë e Punëve Publike dhe Transportit, fton konsulentë të kualifikuar për të shprehur interesin e tyre për ofrimin shërbimeve të sipërpërmendura. Konsulentët e interesuar duhet të paraqesin informacion që janë të kualifikuar për kryerjen e këtyre shërbimeve (broshura, përshkrim te shërbimeve te ngjashme, eksperienca te ngjashme pune, disponueshmërinë e stafit me aftësitë e duhura, etj.).

Konsulenca do të përzgjidhet në përputhje me procedurat e përcaktuara në Udhëzimin e Bankës Botërore: Përzgjedhja dhe Punësimi i Konsulentëve nga Huamarrësit e Bankës Botërore (botimi fundit), dhe mënyra e përzgjedhjes do të jetë Quality and Cost-Based Selection (QCBS)

Konsulentët e interesuar mund të marrin më shumë informacion në adresën e mëposhtme nga ora 8^{00} deri ne orën 16^{30} nga e Hëna deri të Enjte, dhe nga ora 8^{00} deri 14^{00} ditën e Premte.

Shprehjet e interesit duhet të dorëzohen në adresën e mëposhtme jo më vonë se data **21 Janar 2011.**

Njësia e Menaxhimit të Projektit (PMT)
Në vëmendje të: Sali Kelmendi
Ministria e Brendshme
Sheshi Skënderbej Nr.3 , Tirana, Albania
Tel: +355 42 273 191
e- mail: kelmendisali@yahoo.com
lorenckoci@gmail.com